



**STRATEGJIA PËR KONTROLLIN
E ARMËVE TË VOGLA, TË LEHTA,
MUNICIONEVE DHE EKSPLOZIVËVE
2019 – 2024**





*This project is funded by
the European Union*

Përkthimi, redaktimi dhe printimi i këtij publikimi është mbështetur nga UNDP/SEESAC nëpërmjet një projekti të financuar nga Bashkimi Evropian.

Pikëpamjet e shprehura në publikim janë të Qeverisë së Shqipërisë dhe nuk përfaqësojnë detyrimisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara. Emërtimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në këtë publikim nuk nënkuptojnë shprehjen e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në lidhje me 1) statusin ligjor të një vendi, territori apo zone, ose të autoriteteve të tij; apo 2) përcaktimin e kufijve apo vijave kufitare të tij.



*Empowered lives
Resilient nations.*

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	7
1.1 Qëllimi	7
1.2 Vizioni	7
1.3 Metodologjia	7
2. ANALIZA E SITUATËS	8
2.1 Kërcënimet ndaj sigurisë së brendshme dhe detyrimet në procesin e integritetit në BE.....	8
2.2 Dorëzimi vullnetarisht i armëve	8
2.3 Mënyra e trafikimit të armëve të zjarrit.....	9
2.4 Sfidat që kemi përpara.....	9
2.5 Bashkëpunimi ndërkombëtar me partnerët në fushën e trafikimit të armëve të zjarrit.....	10
3. PARIMET E PËRGJITHSHME	11
4. KORNIZA LIGJORE DHE MEKANIZMAT INSTITUCIONAL	12
4.1 Korniza ligjore	12
4.2 Angazhimet institucionale	13
5. OBJEKTIVAT E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT	14
6. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË	17
6.1 Indikatorët për monitorim dhe vlerësim.....	17
PLANI I VEPRIMIT 2019-2021 I STRATEGJISË PËR KONTROLLIN E ARMËVE TË VOGLA, TË LEHTA, MUNICIONEVE TE TYRE DHE EKSPLOZIVËVE 2019 – 2024	18
OBJEKTIVI 1: Brenda vitit 2023, të garantohet miratimi i legjislacionit për kontrollin e armëve, plotësisht i harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së, dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare përkatëse dhe i standardizuar me të gjithë rajonin.....	18
OBJEKTIVI 2: Brenda vitit 2024, të garantohet se politikat dhe praktikatat për kontrollin e armëve në vendin tonë janë bazuar në statistika dhe udhëhiqen nga informacionet e inteligjencës	20
OBJEKTIVI 3: Brenda vitit 2024, të ulet në mënyrë të konsiderueshme qarkullimi i paligjshëm i armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (AME) drejt, brenda dhe përtej vendit tonë	26
OBJEKTIVI 4: Brenda vitit 2024, të ulet në mënyrë të konsiderueshme oferta, kërkesa dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit nëpërmjet ndërgjegjësimit, edukimit, informimit dhe promovimit të kontrollit.....	30
OBJEKTIVI 5: Brenda vitit 2024, të ulet mjaftueshëm numri i përlloritur i armëve të zjarrit që mbahen në mënyrë të paligjshme në Shqipëri	32
OBJEKTIVI 6: Në mënyrë sistematike, të ulet sasia e tepërt dhe të shkatërrohen armët e vogla dhe të lehta dhe municionet të tyre të kapura, duke respektuar standardet mjedisore	34
OBJEKTIVI 7: Të ulet në mënyrë të konsiderueshme rreziku i përhapjes dhe devijimit të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve	36

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Lufta kundër krimit dhe përmirësimi i rendit dhe sigurisë publike në Shqipëri janë dhe mbeten prioritetet strategjike për Qeverinë e Shqipërisë.

Armët e zjarrit dhe municionet luftarake pa leje në duart e qytetarëve dhe keqpërdorimi i tyre, vijojnë të jenë burim i rrezikut serioz për vetë jetën e qytetarëve, si dhe për rendin dhe sigurinë publike.

Duke vlerësuar këtë rrezik, edhe si një pengesë serioze për zhvillimin social dhe ekonomik të vendit, me ndikim në parametrat e sigurisë publike, si dhe me efekt negativ për sigurinë e qytetarëve, Policia e Shtetit në vazhdimësi i ka kushtuar vëmendje të veçantë parandalimit të veprave penale të armëmbajtjes pa leje, por edhe të veprave të tjera penale që kanë të bëjnë me trafikimin e armëve, të municioneve etj.

Trafikimi dhe zotërimi i paligjshëm i armëve, krimet me armë, eksplozivët dhe prekursorët e tyre, edhe pse paraqiten në rënie çdo vit, ende shfaqen si kërcënim për jetën njerëzore dhe rendin e sigurinë publike. Kur armët e paligjshme, municioni dhe eksplozivët analizohen në kontekst të sigurisë dhe kërcënimeve nacionale, siç është lufta kundër terrorizmit, atëherë kontrolli, menaxhimi si dhe lufta ndaj paligjshmërisë të këtij sektori merr një dimension të ri, të cilit duhet kushtuar vëmendje dhe resurse të veçanta.

Ndër-veprimi dhe bashkëpunimi mes grupeve kriminale me ato terroriste, nuk njihet kufij ndarës prandaj edhe qasja e kësaj strategjie duhet të jetë ndër-institucionale.

Përveç kërkesave të brendshme për rritjen e sigurisë publike, kjo strategji do të kontribuojë edhe në sigurinë rajonale dhe të BE-së nëpërmjet kontrollit kufitar, si dhe duke luftuar eksportet dhe importet e paligjshme të armëve, municionit, eksplozivëve dhe prekursorëve të tyre.

Lufta kundër terrorizmit kërkon që përveç kontrollit, menaxhimit dhe luftimit të armëve të paligjshme, municionit dhe eksplozivëve, të krijojmë masa shtesë të kontrollit dhe mbikqyrjes së personelit dhe personave juridik shtetërorë e private të cilët importojnë dhe përdorin eksplozivët e prekursorët e tyre.

Prioriteti i Policisë së Shtetit ka qenë, është dhe do të jetë në vazhdimësi, krijimi i një ambienti sa më të sigurt për qytetarët vendas apo të huaj, bizneset dhe shoqërinë në tërësi.

Mbajtja pa leje e armëve të zjarrit në vendin tonë aktualisht është shqetësuese, kjo për shkak të situatës së trashëguar në vite, por edhe për shkak të rritjes së qarkullimit të mallrave dhe njerëzve, gjë që sjell si pasojë edhe rritjen e aktivitetit kriminal në fushën e trafikimit të paligjshëm të armëve dhe municioneve.

Policia e Shtetit punon në vazhdimësi për minimizimin e veprave penale të mbajtjes së armëve të zjarrit pa leje, duke identifikuar personat që mbajnë armë pa leje dhe organizuar punën për kapjen e tyre në flagrancë, por edhe të veprave penale të tjera që kanë të bëjnë me trafikimin e armëve etj.

Zotërimi i armëve të zjarrit si dhe keqpërdorimi i tyre shfaqin një dimension të dukshëm gjinor. Shumica e mbajtësve të licencave të armëve të zjarrit në Shqipëri janë burra (99.9%). Burrat gjithashtu përbëjnë shumicën dërrmuese të autorëve të incidenteve me armë zjarri (98%) dhe mbizotërojnë ndermjet viktimave (89%). Gratë në anën tjetër zoterojnë vetëm një pjesë të vogël të armëve të zjarrit, rrallë i keqpërdorin ato, por përfaqësohen në mënyrë të shpërpjestuar ndermjet viktimave (11%). Shumica e viktimave gra janë për arsye të dhunës në familje dhe keqpërdorimin e armëve të zjarrit brenda këtij konteksti.

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar një sërë ligjesh në lidhje me armët që synojnë një kontroll më efektiv të tyre, si:

- a. Kodin Penal në të cilin, në disa dispozita janë përcaktuar veprat penale të cilat kanë të bëjnë me armëmbajtjen dhe municionet pa leje, trafikimin e armëve dhe municioneve etj.
- b. Ligji nr. 74/2014 "Për armët".
- c. Ligji nr. 72/2014 "Për përdorimin e armëve të zjarrit".
- d. Ligjin nr. 9126, datë 29.7.2003 "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse dhe lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me Ligjin Nr. 10 388, datë 03.03.2011 dhe Ligjin nr. 73/2014.
- e. Ligji nr. 9020, datë 6.3.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për etiketimin e eksploziveve plastike për qëllime zbulimi".

Me aktet normative të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimet e Ministrit të Brendshëm apo edhe të institucioneve të tjera të ngarkuara me ligj, paketa e akteve ligjore dhe nënligjore

në Shqipëri është e plotë për të lejuar aktivitete të ligjshme me armët, për atë kategori që plotëson kushtet dhe kriteret, por edhe për të penalizuar ata shtetas, të cilët synojnë të ushtrojnë dhe organizojnë aktivitete të paligjshme në këtë drejtim.

Vendi ynë i është bashkuar marrëveshjeve kryesore ndërkombetare të kontrollit të armëve duke përfshirë: Traktatin e Tregtisë së Armëve, Programin e Veprimit për Armët e Vogla dhe të Lehta të Kombeve të Bashkuara, Protokollin e Armëve të Zjarrit si dhe ka përqafuar iniciativat rajonale për forcimin e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta (AVL), në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në të gjithë rajonin.

Republika e Shqipërisë i ka shkatërruar armët dhe municionet e tepërta të trashëguara nga sistemi i kaluar, në vitin 2016. Ministria e Mbrojtjes ka bashkëpunuar ngushtësisht me partnerët ndërkombëtarë në përmbushjen e këtij angazhimi. Në procesin e reduktimit, shkatërrimit të ALV, Forcat e Armatosura (FA) të RSH janë asistuar edhe nga organizata ndërkombëtare dhe vende partnere, si NATO, UNDP SEESAC, Gjermania, SHBA, Norvegjia, Britania e Madhe, Kanadaja, OSBE etj.

Gjithashtu, ka procedura ligjore për armatimet e tepërta që dalin herë pas here nga inventarizimi dhe konfiskimet.

Me urdhër të Kryeministrit është ngritur Komisioni Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL), i cili është organizëm ndërministror përgjegjës për planifikimin, koordinimin, monitorimin dhe raportimin e të gjitha aktiviteteve të lidhura me kontrollin e armëve në Republikën e Shqipërisë, me qëllim për të siguruar një mjedis të sigurtë dhe për të krijuar në këtë mënyrë kushte të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Komisioni Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta ka si objektiva kryesore të:

- Hartojë Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Kontrollin e AVL, në përputhje me fushat e përgjegjësisë dhe bazuar në një vlerësim të plotë të situatës së kontrollit të armëve në Shqipëri, si dhe të kryej monitorimin dhe raportimin për zbatimin e objektivave të kësaj Strategjie.
- Përmbushë angazhimet e vendit tonë në kuadër të OKB-së, detyrimeve të integritit në Bashkimin Evropian, si dhe në kuadër të nxitjes së bashkëpunimit rajonal për rritjen e mirëkuptimit, paqes dhe stabilitetit.

Strategjia dhe Plani i Veprimit siguron dhe monitoron përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë sipas marrëveshjeve dhe dokumenteve të ndryshme ndërkombëtare në fushën e kontrollit të armëve (duke përfshirë Programin e Veprimit të OKB-së, Dokumentin e OSBE-së për AVL, Traktati i Tregtisë së Armëve, Protokollin e Kombeve të Bashkuara kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të AVL, Kodi i Sjelljes i BE etj., si dhe përputhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB.

Në mënyrë të veçantë Strategjia dhe Plani i Veprimit i referohen "Udhërrëfyesit për një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e paligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) dhe municioneve të tyre, në Ballkanin Perëndimor, brenda vitit 2024".

Objektivat e Strategjisë dhe Planit të Veprimit janë të njëjta me Udhërrëfyesin rajonal dhe po ashtu dhe indikatorët e performancës.

Edhe pse vendi ynë ka një ligj 74/2014 "Për Armët", miratimi për herë të parë të pronësisë private mbi armët, ka nevojë për ndryshime, jo vetëm për shkak të eksperiencës së krijuar gjatë zbatimit të tij, por edhe për faktin se Direktiva e Armëve të Zjarrit të BE-së ka ndryshuar në vitin 2017.

OBJEKTIVI 1	Brenda vitit 2023, të garantohet miratimi i legjislationit për kontrollin e armëve, plotësisht i harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së, dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare përkatëse dhe i standardizuar me të gjithë rajonin.
OBJEKTIVI 2	Brenda vitit 2024, të garantohet se politikat dhe praktikat për kontrollin e armëve në vendin tonë janë bazuar në statistika dhe udhëhiqen nga informacionet e inteligjencës.
OBJEKTIVI 3	Brenda vitit 2024, të ulet në mënyrë të konsiderueshme qarkullimi i paligjshëm i armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (AME) drejt, brenda dhe përtej vendit tonë.
OBJEKTIVI 4	Brenda vitit 2024, të ulet në mënyrë të konsiderueshme oferta, kërkesa dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit nëpërmjet ndërgjegjësimit, edukimit, informimit dhe promovimit të kontrollit.
OBJEKTIVI 5	Brenda vitit 2024, të ulet mjaftueshëm numri i përlogaritur i armëve të zjarrit që mbahen në mënyrë të paligjshme në vendin tonë.
OBJEKTIVI 6	Në mënyrë sistematike, të ulet sasia e tepërt dhe të shkatërrohen armët e vogla dhe të lehta dhe municionet e tyre të kapura, duke respektuar standardet mjedisore.
OBJEKTIVI 7	Të ulet në mënyrë të konsiderueshme rreziku i përhapjes dhe devijimit të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve.

LISTA E SHKURTESAVE

MB	Ministria e Brendshme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MEPJ	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PSH	Policia e Shtetit
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
AKSHE	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve
BE	Bashkimi Evropian
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
OSBE	Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
KiE	Këshilli i Europës
AVL	Armët e Vogla dhe të Lehta
AME	Armët, Municionet dhe Eksplozivët
SELEC	Qendra e Zbatimit të Ligjit e Europës Juglindore
SEESAC	Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta
SEEFEN	Rrjeti i Europës Juglindore i Ekspertëve të Armëve të Zjarrit
SEEFEG	Grupi i Europës Juglindore i Ekspertëve të Armëve të Zjarrit
FFP/NJQA	Njësia Qendrore për Armët e Zjarrit



1. HYRJE

1.1 QËLLIMI

Qëllimi kryesor i kësaj Strategjie gjashtëvjeçare është kontrolli i plotë mbi armët e vogla dhe të lehta, municionet dhe eksplozivët, duke u bazuar në kërkesat vendore dhe standardet e BE-së, OKB-së dhe OSBE-së.

Ky dokument strategjik ka për qëllim të caktojë orientime të përgjithshme për institucionet dhe agjencitë të cilat zbatojnë aktivitete të Strategjisë për vitet e ardhshme.

Dokumenti paraqet vizionin e Qeverisë së Shqipërisë për kontrollin e armëve, municionit dhe eksplozivëve dhe planin përkatës të veprimit.

Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit, që pason ngritjen e Komisionit Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta citohet dhe në progres-raportet e Komisionit Europian të viteve të fundit.

Republika e Shqipërisë ka marrë përsipër të promovojë stabilitetin dhe sigurinë, jo vetëm brenda vendit, por edhe të jetë kontribuese e rëndësishme ndaj sigurisë së rajonit dhe më gjerë. Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e kontrollit dhe luftës kundër trafikimit të paligjshëm me AVL-të dhe Eksplozivët mbetet një nga prioritetet e Qeverisë.

1.2 VIZIONI

Republika e Shqipërisë të jetë një vend me një mjedis të sigurt dhe me kapacitete të qëndrueshme, për të parandaluar, kontrolluar dhe dënuar keqpërdorimin, trafikimin dhe zotërimin e paligjshëm të armëve të zjarrit, municioneve

dhe eksplozivëve, në harmoni me standardet e Bashkimit Europian dhe ato ndërkombëtare.

1.3 METODOLOGJIA

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Kontrollin e AVL-të dhe Eksplozivët është hartuar duke u mbështetur në vlerësimet dhe analizat e agjencive të specializuara, të dhënave statistikore nga institucionet qeveritare dhe ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri dhe jashtë saj.

Kjo strategji është mbështetur në kërkesat e Bashkimit Evropian të cilat burojnë nga "Plani i Veprimit të BE-së kundër trafikimit dhe përdorimit të armëve të zjarrit dhe eksplozivëve", si dhe Programi për Veprim i Kombeve të Bashkuara.

Kjo Strategji është bazuar në praktikatat dhe standardet e tjera ndërkombëtare (OKB). Në këtë kontekst, kjo Strategji tenton të jetë në harmoni me standardet dhe rregulloret përkatëse të BE-së dhe ato ndërkombëtare.

Në mënyrë të veçantë Strategjia dhe Plani i Veprimit i referohen "Udhërrëfyesit për një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e paligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) dhe municioneve të tyre, në Ballkanin Perëndimor, brenda vitit 2024".

Kryeministri i Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Urdhërit Nr. 69, datë 22.05.2017, caktoi ngritjen e Komisionit Kombëtar të Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL), kryesimin e komisionit nga Zëvendësministri i Brendshëm dhe përbërjen e komisionit.



2. ANALIZA E SITUATËS

2.1 KËRCËNIMET NDAJ SIGURISË SË BRENDSHME DHE DETYRIMET NË PROCESIN E INTEGRIMIT NË BE

Armët e Vogla dhe të Lehta, nëse nuk kontrollohen, mund të paraqesin kërcënim për sigurinë e brendshme apo burim i rreziqeve për rajonin dhe BE-në. Armët ndikojnë tek njerëzit, komunitetet dhe bizneset. Ato vazhdojnë të shkaktojnë humbje të jetëve, dëme ekonomike dhe sociale si dhe frikë për publikun.

Vendi ynë ka zgjidhur procedurat e trajtimit të stoqeve të armëve municioneve dhe eksplozivave të kapura e sekuestruara ku me Vendim të Këshillit të Ministrave herë pas here këto armatime dorëzohen në Ministrinë e Mbrojtjes për t'u trajtuar në uzinat ushtarake me procedura të demontimit.

Në muajin Janar 2018, përfundoi anketimi mbi shpërndarjen e armëve dhe ndikimin e tyre dhe nga ky ballafaqim rezultot të kemi informacione jo të plota për ngjarjet specifike

me armë, gjë që do të mbetet një nga detyrimet në planin e veprimit të Strategjisë së AVL për të standardizuar statistikat.

Strategjia dhe Plani i Veprimit synon të japë një zgjidhje gjithëpërfshirëse problematikave të armëmbajtjes pa leje dhe aktiviteteve në reduktimin e armëmbajtjes pa leje të armëve të zjarrit përmes konfiskimit, legalizimit, dorëzimit vullnetar, çaktivizimit.

Gjatë periudhës 2006-2017 në total në shkallë vendi janë evidentuar 9.380 vepra penale të armëmbajtjes pa leje, janë zbuluar 8,268 prej tyre, ose 88.1%, me 9.687 autorë. Ajo që të bën përshtypje është fakti se trendi i kësaj vepre penale pas vitit 2012, ka shënuar rritje në raport me vitet e mëparshme.

Gjatë vitit 2017 janë identifikuar 1,090 autorë të veprave penale të armëmbajtjes pa leje, nga të cilët 587 janë arrestuar, ose 54%, 111 janë ndaluar, ose 10%, 246 ndiqen në gjendje të lirë, ose 23% dhe 139 autorë janë shpallur në kërkim, ose 13% e totalit të autorëve të veprave penale të armëmbajtjes pa leje.

2.2 DORËZIMI VULLNETARISHT I ARMËVE

Pas ngjarjeve të vitit 1997 ku në Shqipëri u grabitën armë, municione, granata dhe pajisje ushtarake nga depot e shtetit, në vendin tonë janë zbatuar disa amnisti për dorëzimin vullnetar të armëve, me qëllim për të mos penalizuar në masë shtetasit shqiptarë, duke u dhënë mundësinë atyre të dorëzojnë armët që mbajnë pa leje dhe që janë pronë e shtetit.

Amnistia e parë me kohëzgjatje Gusht 1998 - Gusht 2002, kur u hartua dhe miratua Ligji Nr. 8388, datë 05.08.1998 "Për grumbullimin e Armëve dhe municioneve Luftarake",

ligj i cili vendosi parimet dhe metodat për dorëzim vullnetar të armëve, regjistrimin për një kategori biznesmenësh, si dhe grumbullimin e detyruar nga policia.

Amnistia e dytë u hartua në Dhjetor 2002, me një amnisti dhe ligj për grumbullimin e armëve, që u miratua në 6 Mars 2003, Ligji Nr. 9018 "Për grumbullimin e armëve, municioneve dhe pajisjeve të tjera luftarake". Edhe ky ligj kishte qëllime, parime, detyra të njëjta për policinë e ushtrinë, si dhe të njëjtën strukturë të komisioneve të grumbullimit të armëve në Shqipëri. Ligji qëndroi në fuqi deri në 31 Maj 2005.

Shifrat e grumbullimit të armëve gjate dy amnistive:

	Municione	Eksplzivë	Armë
GRABITUR NË 1997	839,310,038	16,000,000	549,775
GRUMBULLUAR: MARS 1997 – QERSHOR 2005	118,134,222	1,539,828	222,918 ose 40.54%

Një amnisti e tretë u zbatua edhe gjatë periudhës Janar-Prill 2017, ku si rezultat i organizimit të punës dhe aktiviteteve sensibilizuese, janë dorëzuar vullnetarisht në shkallë vendi:

- 1.603 armë zjarri të ndryshme.
- 1.558 granata dore.
- 580.634 municione të ndryshme.

Mesatarisht i takon çdo ditë të jenë dorëzuar në shkallë vendi 13 armë zjarri të ndryshme. Kjo situatë tregon se, akoma në duart e qytetarëve ndodhen një numër i konsiderueshëm armë zjarri dhe municione luftarake pa leje.

Sondazhi i opinionit publik i kryer në vitin 2016 nga SEESAC nëpërmjet agjencisë lider në botë të sondazheve "IPSOS", tregoi se mbi 60% e qytetarëve shqiptarë janë kundër posedimit të armëve të zjarrit pavarësisht rrethanave, ndërkohë që 78% e tyre besojnë se Policia e Shtetit është kontribuesi kryesor për sigurinë në vend.

Aplikimi i herëpashershëm i amnistisë për armëmbajtjen pa leje për një periudhë 2-3 mujore, bashkëpunimi i Policisë së Shtetit për sensibilizimin e qytetarëve me organizatat ndërkombëtare, median, institucionet e tjera shtetërore dhe OJF të ndryshme, do të ndikonte pozitivisht në rritjen e numrit të armëve dhe municioneve të dorëzuara vullnetarisht, të cilat mbahen pa leje nga popullata.

Situata e trafikimit të armëve të zjarrit, municioneve, lëndëve plasëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, është kryer duke pasur parasysh faktorë të tillë si ekzistenca e armëve të zjarrit të trashëguara nga e kaluara, si dhe të armëve të reja dhe pozita gjeografike e vendit tonë.

Në bazë të armëve të sekuestruara nga ana e policisë në veprat e ndryshme penale për të cilat janë kryer dhe ekspertimet tekniko-balistike, është përcaktuar dhe origjina e prodhimit të armëve të zjarrit. Nga këto masa, krijojmë një tablo të përgjithshme ku marrin përgjigje pyetjet: çfarë armë zjarri qarkullojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, trendin e lëvizjes së tyre, në çfarë veprash penale përfshihen ato, grupmoshat, zonat ku janë të përqendruara etj.

Shqetësim mbeten lëndët plasëse të trashëguara nga e kaluara, TNT, dinamitet që përdoren nga elementët kriminal, të cilat janë të vështira gjatë hetimeve në zbulimin e autorëve të tyre.

Nga analizimi i ngjarjeve kriminale të ndodhura përgjatë vitit 2017 në territorin e Republikës së Shqipërisë, është konstatuar se grupet kriminale për të mbrojtur aktivitetin e tyre si dhe për të eliminuar kundërshtarët e tyre, gjithmonë e më shumë po përdorin lëndët plasëse më telekomandim në distancë. Hetimet e kryera në disa ngjarje kriminale kanë dëshmuar se origjina e disa lëndëve plasëse vjen nga ish arsenali i trashëguar nga viti 1997.

Gjithashtu nga veprimet hetimore të kryera, është konstatuar se në disa raste montimi i mekanizmit të telekomandës së shpërthimit në distancë të këtyre lëndëve plasëse, janë kryer nga persona brenda vendit tonë.

2.3 MËNYRA E TRAFIKIMIT TË ARMËVE TË ZJARRIT

Në përgjithësi nga raste e konstatuara, trafikantët e armëve të zjarrit përdorin kufirin tokësor të gjelbër duke i fshehur në automjete, autobuzë, kamiona, vetura ose i transportojnë

në trup duke kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme. Nga rastet e hetuara është konstatuar se trafikimi i armëve të zjarri bëhet në sasi të vogla, nga 1-2 copë. Grupmoshat e evidentuara janë kryesisht të seksit mashkull dhe variojnë nga mosha 16-45 vjeç.

Nga analizimi i situatës operative si dhe nga rastet e konstatuar armët e zjarrit në territorin e Shqipërisë futen nga kufiri: Maqedoni-Shqipëri, Kosovë-Shqipëri dhe Mali i Zi-Shqipëri. Në këtë pjesë të kufirit trafikohen armë zjarri të prodhuara në vendet e Evropës (pistoleta), si dhe armë zjarri, lëndë plasëse që vijnë nga territori i Malit të Zi, kurse nga territori i Kosovës dhe Maqedonisë trafikohen kryesisht pistoletat e konvertuara. Ndërsa nga territori i Shqipërisë, nëpërmjet kufirit Shqipëri-Greqi dhe Shqipëri-Itali, trafikohen pistoletat dhe automatikë që janë rrëmbyer nga depot ushtarake në vitin 1997 në Shqipëri.

Nga sa është konstatuar rezulton se vepra penale e trafikimit të armëve të zjarrit ndër vite është në tendencën e rënies, dhe kjo ka ardhur për disa arsye:

- a. Aktiviteti kriminal i trafikimit të armëve të zjarrit ka kaluar si aktivitet dytësor.
- b. Fitimet e krijuara nga ky aktivitet janë me të ulëta në krahasim me aktivitetet e tjera kriminale.
- c. Rritja e masës ndëshkuese e dënimit për këtë veprë penale (ndryshimet në Kodin Penal të RSH, ka rritur numrin e viteve të dënimit me burg).
- d. Vendi jonë nuk është vend prodhues i armëve të zjarrit.
- e. Pozita gjeopolitike nuk e ka favorizuar veprimtarinë e trafikimit të armëve të zjarrit, ndodhet larg nga vendet në konflikt.
- f. Rritja e efikasitetit të agjencive ligjzbatuese në vend, në veçanti e strukturave të Policisë së Shtetit.

2.4 SFIDAT QË KEMI PËRPARA

Vëmendje të veçantë duhet t'i kushtojmë rritjes dhe forcimit të kapaciteteve njerëzore, specialistëve në fushën e hetimit të veprës penale të trafikimit të armëve të zjarrit, rritja e profesionalizmit të tyre.

Procesi i gjurmimit të armëve të zjarrit në shkallë ndërkombëtare, integrimi i sistemit kombëtar të regjistrimit të armëve të zjarrit i quajtur SIMA, me sistemet e homologëve tanë.

Forcimi i kontroleve kufitare ku në fokus do të jetë: rritja e profesionalizmit të punonjësve në PKK dhe mbështetja logjistike në kontrollin kufitar, duke vendosur pajisje si, skaner, detektor etj., të cilat do të rritin sigurinë në kontrollet kufitare.

Regjistrimi i të gjithë armëve të zjarrit, ku përfshihen ato që tregëtohen, që janë në përdorim, që deklarohen të vjedhura, të humbura, të sekuestruara në vepra penale, në një database të quajtur SIMA. Pra të gjitha këto masa, të jenë në funksion të mbylljes së ciklit të armëve të zjarrit, që nga gjetja e origjinës së prodhimit të tyre, deri tek përdoruesit apo shkatërrimi përfundimtar i tyre.

2.5 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR ME PARTNERËT NË FUSHËN E TRAFIKIMIT TË ARMËVE TË ZJARRIT

Bashkëpunimi ndërkombëtar në luftën kundër trafikimit të armëve të zjarrit, municioneve, lëndëve plasëse vlerësohet shumë i rëndësishëm, kryesisht në drejtimet e mëposhtme:

1. Bashkëpunim në fushën e grumbullimit të informacioneve, në bazë të të cilave do të bëhet analizimi i hollësishëm i rasteve dhe do të identifikohet prania e veprimtarisë kriminale të trafikimit të armëve të zjarrit.
2. Krijimi i skuadrave të hetimit të përbashkëta me pjesëmarrjen e hetuesve nga secili shtet kur ka premisa të zhvillimit të veprimtarisë kriminale të trafikimit të armëve të zjarrit. Krijimi i skuadrave të hetimit të përbashkëta, do të ishte më shumë produktive në krahasim me organizimin e operacioneve rajonale me pjesëmarrjen e shumë shteteve, për të rritur:
 - Cilësinë e shkëmbimit të informacionit.
 - Besueshmërinë e anëtarëve të skuadrës së hetimit.
 - Shmangien e pengesave burokratike.
 - Shkëmbimin e eksperiencave.
3. Në fushën e rritjes së profesionalizmit të hetuesve për veprimtarinë kriminale të trafikimit të armëve të zjarrit, ku një vend të veçantë duhet të marrin hetimet në fushën e DARK NET-it.
4. Fuqizimin e bazës së të Dhënave për Regjistrimin e Armëve të zjarrit për çdo shtet dhe unifikimi i tyre në një Bazë të vetme Ndërkombëtare.



3. PARIMET E PËRGJITHSHME

Struktura dhe përmbajtja e këtij dokumenti bazohet në këto parime:

<p>PARIMI I KUSHTETUTSHMËRISË DHE LIGJSHMËRISË</p> <p>masat e parashikuar bazohen në dispozitat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, legjislativonin në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare.</p>	<p>PARIMI I SIGURISË SHTETËRORE</p> <p>kontrolli i AVL-ve dhe Eksplozivëve është pjesë përbërëse e sigurisë shtetërore, mbështet funksionimin e shtetit dhe shoqërisë të bazuar në rend dhe ligj, konkurrueshmërinë e ekonomisë dhe inovacionin. Ky parim nënkupton mbrojtjen e të drejtës për siguri dhe mbrojtje për të gjithë qytetarët, përmes parandalimit, luftimit dhe kontrollit.</p>
<p>PARIMI I TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT</p> <p>garantohet me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, duke garantuar të drejtat dhe liritë themelore, si dhe duke mbrojtur liritë individuale, informacionet personale, si dhe identitetin, pa marrë parasysh etninë, gjininë, moshën, fenë dhe orientimin seksual. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë të jetojnë në një mjedis të mbrojtur dhe të sigurtë nga keqpërdorimi i AVL-ve.</p>	<p>PARIMI I PËRGJEGJËSISË</p> <p>për shkak të kompleksitetit, shteti nuk mund të mbajë përgjegjësinë si i vetëm për parandalimin, mbrojtjen dhe vetëdijësimin ndaj rrezikut që paraqet keqpërdorimi i AVL-ve dhe eksplozivëve. Prandaj, pjesë të ndryshme të shoqësisë dhe sektori privat kanë përgjegjësi, për parandalimin, mbrojtjen dhe vetëdijësimin ndaj rrezikut nga AVL-të dhe eksplozivët.</p>
<p>PARIMI I GJITHËPËRFSHIRJES</p> <p>është thelbësore të zhvillohet një qasje gjithëpërfshirëse në përballimin me kërcënimet nga AVL-të dhe Eksplozivët që paraqiten si rrezik ndaj sigurisë së brendshme.</p>	<p>PARIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR</p> <p>lufta kundër trafikimit të paligjshëm me AVL dhe Eksplozive si dhe standardizimi i legjislativonit dhe praktikave avancohet përmes bashkëpunimit ndërkombëtar me partnerët. Përmes bashkëpunimit, Shqipëria do të luajë rol të rëndësishëm në promovimin e sigurisë së brendshme dhe rajonale.</p>

4. KORNIZA LIGJORE DHE MEKANIZMAT INSTITUCIONAL

4.1 KORNIZA LIGJORE

Në fushën e kontrollit të AVL-ve dhe Eksplozivëve, Republika e Shqipërisë ka në zbatim një bazë të gjerë ligjore, si:

A.	Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;
B.	Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
C.	Ligji nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale të RSH, i ndryshuar
D.	Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
E.	Ligji nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar;
F.	Ligji nr. 43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë";
G.	Ligji nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar";
H.	Ligji Nr. 74/2014 "Për armët";
I.	Ligji Nr. 72/2014 "Për përdorimin e armëve të zjarrit";
J.	Ligji nr. 10253, datë 11.03.2010 "Për gjuetinë", i ndryshuar;
K.	Ligji nr. 9126, datë 29.7.2003 "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse dhe lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin Nr. 10 388, datë 03.03.2011 dhe Ligjin Nr. 73/2014;
L.	Ligji nr. 9020, datë 6.3.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për etiketimin e eksploziveve plastike për qëllime zbulimi";
M.	Ligji nr. 9126, datë 29.7.2003 "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse dhe lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me Ligjin Nr. 10 388, datë 03.03.2011 dhe Ligjin nr. 73/2014.
N.	Ligji Nr.46/2018 "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë";
O.	Ligji nr. 9272, datë 16/09/2004, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen Evropiane Për transportin rrugor ndërkombëtar të artikujve të rrezikshëm (ADR) dhe protokollin e zbatimit".
P.	Ligjin Nr. 6/2014, datë 30.01.2014 "Për ratifikimin e Traktatit për Tregtinë e Armëve"
Q.	Ligji Nr. 102/2014 "Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë"
R.	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 275 datë 1.4.2015, qe miraton rregulloren për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve;

4.2 ANGAZHIMET INSTITUCIONALE

Angazhimet institucionale nënkuptojnë të gjithë mekanizmat të cilët kanë rol dhe rëndësi primare dhe sekondare në zbatimin e strategjisë. Angazhimet institucionale për hartimin dhe zbatimin e strategjisë janë si më poshtë:

Komisioni Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta.

Është përgjegjës për hartimin e politikave mbi armët e vogla dhe të lehta në Shqipëri. Koordinon dhe mbledh informacione dhe statistika nga institucionet përkatëse për prodhimin, tregtimin, çaktivizimin, asgjësimin, përdorimin e paligjshëm të armëve, kontrollin e armëve të lejuar, kontrollin e importit dhe eksportit të armëve. Është përgjegjës të bashkërendojë, udhëzojë, monitorojë dhe të raportojë për zbatimin e politikave që lidhen me AVL.

Ministria e Brendshme është përgjegjëse për propozimin, hartimin, monitorimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislationin në fushën e armëve dhe eksplozivëve.

Policia e Shtetit është institucioni kryesor i ngarkuar me luftën kundër trafikeve të paligjshme të armëve, municioneve dhe eksplozivëve, në bashkëpunim me institucionet e tjera ligjzbatuese për parandalimin dhe zbulimin e trafikeve të paligjshme në kufi dhe brenda territorit të vendit. PSH jep licencat dhe autorizimet për veprimtaritë e lejuara në armë, për personat fizik dhe juridikë në përputhje me ligjin legjislationin vendas dhe ndërkombëtar. PSH ushtron kontrollin në SHPSF dhe personat e tjerë juridikë të licensuar për të mbajtur armë mbi kushtet e sigurisë së mbajtjes së armëve.

Njësia Qendrore e Armëve të Zjarrit (FFP): ngritja e kësaj njësie është përgjegjësi e Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. NJQA do të punojë për përsosjen e formave dhe procedurave për regjistrimin e të dhënave për shpërndarjen dhe ndikimin e armëve të zjarrit AVL, statistikat gjinore dhe procedurat për shkëmbimin e detyrueshëm të informacionit me vendet e rajonit. Procedurat për shkëmbim informacioni në sistemet që bartin të dhëna për armët.

Ministria e Mbrojtjes është përgjegjëse për sigurinë e depove ushtarake të armatimeve, shkatërrimin e armëve, municioneve dhe eksplozivëve tepicë, në përputhje me standardet e NATO-s. MM gjithashtu është aktor i rëndësishëm në sigurinë e kufijve detarë në ndihmë të institucioneve ligjzbatuese.

AKSHE është institucioni përgjegjës për zbatimin e politikës shtetërore në fushën e kontrollit të eksporteve dhe importeve të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë. Krijimi dhe veprimtaria e tij bazohet në ligjin nr. 46/2018, datë 23.07.2018 "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë" dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 43, datë 16.01.2008 "Për or-

ganizimin, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve". AKSHE është institucioni që licenson importet, eksportet, tranzitin, transship, brokering të mallrave ushtarake dhe mallrave me përdorim të dyfishtë, në zbatim të ligjit nr. 46/2018. Në bazë të rezultateve të ekspertizës, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve identifikon mallrat, përcakton kushtet e transferimit të tyre ndërkombëtar në shtete të veçanta dhe u lëshon/ose jo këtyre subjekteve licencat respektive.

Po ashtu në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. Nr. 658, datë 29.7.2015 "Për përcaktimin e procedurave për dhënie të licencave për prodhimin, çaktivizimin dhe riparimin e armëve", pajis subjektet edhe me licencat prodhimin, çaktivizimin dhe riparimin e armëve.

Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme ndihmon me detyra të veçanta për arritjen e objektivave të kësaj strategjie, sidomos në fushën e bashkëpunimit të institucioneve shqiptare me institucionet partnere dhe organizatat ndërkombëtare, raportimeve ndërkombëtare dhe lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe për kontrollin fundor të eksporteve të armëve, municioneve dhe eksplozivëve.

Ministria e Drejtësisë ndihmon me aktivitete për bashkëpunimin e nevojshëm mes Prokurorisë, Interpolit dhe autoriteteve të huaja të drejtësisë në çështje që lidhen me luftën kundër trafikimit të paligjshëm të armëve. MD është gjithashtu aktore e rëndësishme për përafrimin e akteve ligjore mbi kontrollin e armëve, municioneve dhe eksplozivëve me direktivat e Bashkimit Europian dhe akte të tjera ndërkombëtare.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse për planifikimin dhe zbatimin e detyrave që lidhen me aktet ligjore e normative sipas drejtimeve përkatëse të institucioneve në varësi, në funksion të parandalimit të trafikimit të paligjshëm të armëve, municioneve dhe eksplozivëve.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është përgjegjëse për bashkëveprimin me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit në funksion të garantimit të kufijve të sigurte tokësore, ujorë dhe ajrorë, duke patur për qëllim parandalimin dhe luftimin e trafikimit të paligjshëm të armëve, municioneve dhe eksplozivëve.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë është përgjegjëse për hartimin, ndjekjen dhe zbatimin e politikës shtetërore të ndërgjegjësimit dhe edukimit të brezit të ri kundër armëve, me fokus shkollat, qendrat sportive dhe rinore, duke marrë në konsideratë përfshirjen në orë të veçanta mësimore të rreziqeve nga armët, municionet dhe eksplozivët.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjëse për evidentimin e dëmeve ndaj shëndetit të qytetarëve nga armët e zjarrit duke i shërbyer fushatave ndërgjegjësuese mbi rreziqet nga armët, municionet dhe eksplozivët.

5. OBJEKTIVAT E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT

Strategjia dhe Plani i Veprimit kanë këto objektiva:

OBJEKTIVI 1	OBJEKTIVI 2
Brenda vitit 2023, të garantohet miratimi i legjislacionit për kontrollin e armëve, plotësisht i harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së, dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare përkatëse dhe i standardizuar me të gjithë rajonin.	Brenda vitit 2024, të garantohet se politikat dhe praktikat për kontrollin e armëve në vendin tonë janë bazuar në statistika dhe udhëhiqen nga informacionet e inteligjencës.
OBJEKTIVI 3	OBJEKTIVI 4
Brenda vitit 2024, të ulet në mënyrë të konsiderueshme qarkullimi i paligjshëm i armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (AME) drejt, brenda dhe përtej vendit tonë.	Brenda vitit 2024, të ulet në mënyrë të konsiderueshme oferta, kërkesa dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit nëpërmjet ndërgjegjësimit, edukimit, informimit dhe promovimit të kontrollit.
OBJEKTIVI 5	OBJEKTIVI 6
Brenda vitit 2024, të ulet mjaftueshëm numri i përlogaritur i armëve të zjarrit që mbahen në mënyrë të paligjshme në Shqipëri.	Në mënyrë sistematike, të ulet sasia e tepërt dhe të shkatërrohen armët e vogla dhe të lehta dhe municionet e tyre të kapura, duke respektuar standardet mjedisore.
OBJEKTIVI 7	
Të ulet në mënyrë të konsiderueshme rreziku i përhapjes dhe devijimit të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve.	

OBJEKTIVI 1

BREDA VITIT 2023, TË GARANTOHET MIRATIMI I LEGJISLACIONIT PËR KONTROLLIN E ARMËVE, PLOTËSISHT I HARMONIZUAR ME KUADRIN RREGULLATOR TË BE-SË, DHE DETYRIMET E TJERA NDËRKOMBËTARE PËRKATËSE DHE I STANDARDIZUAR ME TË GJITHË RAJONIN.

Aktivitetet në kuadër të këtij objekti përfshijnë:

Rishikimi i vazhdueshëm i Legjislacionit dhe politikave – ka për qëllim të analizojë dhe ndryshojë legjislacionin primar dhe sekondar si dhe strategjitë e mekanizmat aktual dhe ti sinkronizojë ato me ndryshimet ligjore të BE-së. Në veçanti do të adaptohen dhe plotësohen ligjet si ai për Armët e Zjarrit dhe Rregulloren për Çaktivizimin e Armëve; Ligji për mallrat me përdorim të dyfishtë; Ligji për përdorimin civil të lëndëve plasëse, të përputhet me legjislacionin përkatës të BE-së, në veçanti me legjislacionin për prekursorët si dhe Listën e eksplozivëve të lejuar (OKB). Rishikimi i legjislacionit do të bëhet gjithashtu në përputhje me Protokollin e Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit, Instrumentin Ndërkombëtar për Gjurmim si dhe Traktatin e Tregtisë së Armëve.

OBJEKTIVI 2

BREDA VITIT 2024, TË GARANTOHET SE POLITIKAT DHE PRAKTIKAT PËR KONTROLLIN E ARMËVE NË VENDIN TONË JANË BAZUAR NË STATISTIKA DHE UDHËHIQEN NGA INFORMACIONET E INTELIGJENCËS.

Aktivitetet në kuadër të këtij objekti përfshijnë:

Përmirësimin e vazhdueshëm të punës së institucioneve ligjzbatuese – duke i kushtuar vëmendje informacioneve të inteligjencës, analizën e riskut dhe ngritjen e Njësisë Qendrore për Armët e Zjarrit si dhe forcimin e shkëmbimit të informacionit operacional dhe strategjik, të të dhënave, të informacionit të inteligjencës me agjencitë ndërkombëtare dhe organizmat si Europol, Frontex, Eurojust dhe EMPACT.

OBJEKTIVI 3

BREDA VITIT 2024, TË ULET NË MËNYRË TË KONSIDERUESHME QARKULLIMI I PALIGJSHËM I ARMËVE TË ZJARRIT, MUNICIONEVE DHE EKSPLOZIVËVE (AME) DREJT, BREDA DHE PËRTEJ VENDIT TONË.

Aktivitetet në kuadër të këtij objekti përfshijnë:

Forcimin e kontroleve kufitare në pikat kufitare por dhe në kufirin e gjelbër dhe blu – percaktimi i prioriteteve dhe nevojave për rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe me pajisje e teknologji për Policinë Kufitare, doganat dhe agjencitë për identifikimin, detektimin, analizën dhe hetimin e armëve, municionit dhe eksplozivit për mbikëqyrjen dhe kontrollin kufitar.

Forcimin e bashkëpunimit me mekanizmat ekzistuese dypalëshe, rajonale dhe ndërkombëtare dhe në shkëmbimin e praktikave të mira për të luftuar trafikimin e armëve të zjarrit.

OBJEKTIVI 4

BRENDA VITIT 2024, TË ULET NË MËNYRË TË KONSIDERUESHME OFERTA, KËRKESA DHE KEQPËRDORIMI I ARMËVE TË ZJARRIT NËPËRMJET NDËRGJEGJËSIMIT, EDUKIMIT, INFORMIMIT DHE PROMOVIMIT TË KONTROLLIT.

Aktivitetet në kuadër të këtij objekti përfshijnë:

Zhvillimin e trajnimeve me mediat dhe fushatat sensibilizuese, edukimin e brezit të ri mbi rreziqet e armëve. Ndërgjegjësimi do të jetë një objektivi i të gjithë institucioneve, duke planifikuar masa për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, sidomos të rinjve, shkollave, me angazhimin më të madh të mediave, me mbështetje të gjerë nga ambasadat.

OBJEKTIVI 5

BRENDA VITIT 2024, TË ULET MJAFTUESHËM NUMRI I PËRLOGARITUR I ARMËVE TË ZJARRIT QË MBAHEN NË MËNYRË TË PALIGJSHME NË SHQIPËRI.

Aktivitetet në kuadër të këtij objekti përfshijnë:

Krijimin e hapësirës ligjore që lejon dorëzimin vullnetar dhe/ose legalizimin e armëve;
Planifikimin dhe organizimin e fushatave për dorëzim vullnetar të armëve;
Përdorimin e çaktivizimit në përputhje me standardet e BE si dhe udhëzimin e OSBE, për të reduktuar zotërimin e paligjshëm të armëve të zjarrit;
Rritja e kapaciteteve zbuluese për konfiskimin e armëve të zotëruara në menyrë të paligjshme.

OBJEKTIVI 6

NË MËNYRË SISTEMATIKE, TË ULET SASIA E TEPËRT DHE TË SHKATËRROHEN ARMËT E VOGLA DHE TË LEHTA DHE MUNICIONET E TYRE TË KAPURA, DUKE RESPEKTUAR STANDARDET MJEDISORE.

Aktivitetet në kuadër të këtij objekti përfshijnë:

Vazhdimin e praktikës së mirë të shkatërrimit të armëve dhe municioneve të tepërta që dalin nga inventarizimi periodik dhe atyre të konfiskuara, në përputhje me standardet e sigurisë dhe ato mjedisore.

Shqipëria ka arritur tashmë shumë për këtë objektivi duke shkatërruar plotësisht stokun e armëve të trashëguar nga sistemi i kaluar. Ka procedurë të miratuara tashmë për shkatërrimin e tepricave që krijohen nga konfiskimet dhe dorëzimet.

OBJEKTIVI 7

TË ULET NË MËNYRË TË KONSIDERUESHME RREZIKU I PËRHAPJES DHE DEVIJIMIT TË ARMËVE TË ZJARRIT, MUNICIONEVE DHE EKSPLOZIVËVE.

Aktivitetet në kuadër të këtij objekti përfshijnë:

Përmirësimin e infrastrukturës së sigurisë të depove të armëve, kryesisht të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes si dhe kontrollet gjatë tregtisë së ligjshme të armëve për “përdoruesin fundor”.

UNDP SEESAC me financim nga Bashkimi Europian ka bërë të mundur rikonstrukcionin e tre depove të armëve në vitin 2018, të armatimit të Policisë së Shtetit dhe të mbajtjes së provave, duke u përqendruar te kushtet e sigurisë. Gjithashtu ka patur dhe donacione për rikonstrukcion të depove të forcave të Armatosura dhe të tjera janë planifikuar për vitin e ardhshëm.

6. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË

6.1 INDIKATORËT PËR MONITORIM DHE VLERËSIM

Për matjen e zbatimit të Objektivave do të përdoren 14 Indikatorë performace:

1.	Numri i ligjeve për kontrollin e armëve në Shqipëri plotësisht të harmonizuar me legjislacionin e BE-së, Traktatin për Tregtinë e Armëve dhe Protokollin e OKB-së kundër Prodhimit të Paligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Zjarrit, Pjesëve të tyre, Komponentëve dhe Municioneve (Protokollin për Armët e Zjarrit)
2.	Numri i dokumentave të politikave për kontrollin e armëve të bazuara në fakte, të hartuar në vendin tonë, të cilat trajtojnë gjithashtu nevojat e burrave, të grave, djemve dhe vajzave.
3.	Numri i rasteve, individëve dhe sasia e armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (AME) të keqpërdorura dhe të trafikuar të çuara për ndjekje penale dhe të gjykuara krahasuar me numrin e raporteve të institucioneve ligjzbatuese për konfiskimet;
4.	Numri i rasteve dhe sasia e AME të kapura në territorin e brendshëm krahasuar me numrin e rasteve dhe sasinë e AME të kapura në kufi.
5.	Numri i rasteve të AME të kapura në Bashkimin Europian me prejardhje nga Shqipëria.
6.	Numri i AME-ve për të cilat licencat e eksportit janë lëshuar nga Shqipëria, të identifikuar si të devijuara nëpërmjet procedurës së kontrollit pas transportit.
7.	Njësia Qendrore e Armëve të Zjarrit e ngritur dhe funksionale në Shqipëri;
8.	Numri i rasteve të bashkëpunimit ndërinstucional në nivel operacional, duke përfshirë hetimin, ndjekjen penale dhe fazat paraprake të procedurave gjyqësore;
9.	Numri i rasteve të bashkëpunimit operacional që buron nga informacioni i shërbimeve të inteligjencës, duke përfshirë inteligjencën balistike në luftën kundër krimeve që lidhen me armët e zjarrit, me autoritetet në rajon, shtetet anëtare dhe agjencitë e BE-së si edhe agjencitë ndërkombëtare të zbatimit të ligjit.
10.	Numri i incidenteve me armë zjarri dhe viktimave të prekura nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit, i ndarë sipas gjinisë dhe moshës, në Shqipëri;
11.	Numri i AME-ve të dorëzuara vullnetarisht, si edhe i armëve të zjarrit të legalizuara ose të çaktivizuara;
12.	Numri i armëve, municioneve dhe eksplozivëve të raportuar si të konfiskuar ose tepriçë që shkatërrohet sistematikisht;
13.	Numri i depove për magazinimin e AVL dhe municioneve të tyre që përmbushin standardet ndërkombëtare për sigurinë;
14.	Përqindja e qytetarëve të kënaqur (të ndarë sipas moshës dhe gjinisë) ose që ndihen të sigurtë nga dhuna me armë në Shqipëri.

Komisioni Kombëtar për Armët e Vogla dhe të Lehta, do të kryejë monitorimin e zbatimit të Strategjisë çdo 6 muaj, bazuar mbi këta indikatorë.

PLANI I VEPRIMIT 2019-2021

I STRATEGJISË PËR KONTROLLIN E ARMËVE TË VOGLA, TË LEHTA, MUNICIONEVE TE TYRE DHE EKSPLOZIVËVE 2019 – 2024

OBJEKTIVI 1: BRENDA VITIT 2023, TË GARANTOHET MIRATIMI I LEGJISLACIONIT PËR KONTROLLIN E ARMËVE, PLOTËSISHT I HARMONIZUAR ME KUADRIN RREGULLATOR TË BE-SË, DHE DETYRIMET E TJERA NDËRKOMBËTARE PËRKATËSE DHE I STANDARDIZUAR ME TË GJITHË RAJONINA

KPI 1: Numri i ligjeve për kontrollin e armëve në Shqipëri plotësisht të harmonizuar me legjislacionin e BE-së, Traktatin për Tregtinë e Armëve dhe Protokollin e OKB-së kundër Prodhimit të Paligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Zjarrit, Pjesëve të tyre, Komponentëve dhe Municioneve (Protokolli për Armët e Zjarrit);

KPI 2: Numri i dokumentave të politikave për kontrollin e armëve të bazuara në fakte, të hartuar në vendin tonë, të cilat trajtojnë gjithashtu nevojat e burrave, të grave, djemve dhe vajzave.

<i>Synimet e përgjithshme</i>	<i>Objektivat specifike</i>	<i>Referenca aktuale</i>	<i>Aktivitetet</i>	<i>Palët përgjegjëse</i>	<i>Afati kohor</i>	<i>Buxheti i parashikuar</i>	<i>Burimi i financimit</i>
1. Të vendoset një kuadër ligjor i plotë për të luftuar të gjitha format e keqpërdorimit, trafikimit dhe zotërimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve (AME). ↓	Të miratohen ligjet dhe akte nënligjore në zbatim të tyre lidhur me AME-të për përdorim civil (duke përfshirë ato mbi posedimin e ligjshëm, çaktivizimin, ruajtjen, prodhimin, shitjen me pakicë, tregtimin, transitin, import-eksportin, markimin, armët e pakonvertueshme, gjurmimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen) dhe ato të harmonizohen me kuadrin ligjor të OKB-së, OSBE-së dhe BE-së	Direktiva e BE-së për Armët e Zjarrit; Rregullorja e BE-së për Çaktivizimin; ligji për armët, nuk ka akte nënligjore të harmonizuara për çaktivizimin për markimin mungon teresisht; kërkohet një shqyrtim më i imtësisht dhe miratimi në kohë i legjislacionit dytësor për të garantuar se ai mbështet legjislacionin parësor;	Ngritja e grupeve të punës për ndryshimin e ligjit “Për armët”; Hartimi i ndryshimeve në ligjin “Për armët” dhe shpallja e tyre;	Ministria e Brendshme Policia e Shtetit, Ministria e Mbrojtjes MD MEPJ AKSHE	2019-2021	Kosto administrative	Buxheti i shtetit + BE nëpërmjet SEESAC
		Ligji aktual pjesërisht i perputhur Direktiven 1991	Zbatimi i analizës së mangësive nëpërmjet Tabelës së Përputhshmërisë dhe analizës PESTEL përkatëse;	Ministria e Brendshme Policia e Shtetit, Ministria e Mbrojtjes MD MEPJ AKSHE	2019-2021	Kosto administrative	
	Të miratohet kuadri ligjor lidhur me AME-të për përdorim ushtarak (duke përfshirë ato për ruajtjen, prodhimin, shitjen me pakicë, tregtimin, transitin, import-eksportin dhe mbikëqyrjen) dhe ato të harmonizohen me kuadrin ligjor të OKB-së, OSBE-së dhe BE-së ↓	Eshte miratuar Ligji Nr.46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishte”, ne perputhje me direktivat BE Ne zbatim te Ligjit 74/2014 Për “Armët”, eshte miratuar VKM Nr. 658, datë 29.7.2015 “Për përcaktimin e procedurave për dhënien e licencave për prodhimin, çaktivizimin dhe riparimin e armëve	Ngritja e grupit te punes per miratimin e akteve nenligjore ne zbatim te Ligjit nr.46/2018 Ngritja e grupeve të punës për përcaktimin e VKM Nr. 658, datë 29.7.2015 “Për përcaktimin e procedurave për dhënien e licencave për prodhimin, çaktivizimin dhe riparimin e armëve” me Rregulloren e BE-së për Çaktivizimin,	Ministria e Mbrojtjes AKSHE Ministria e Drejtësisë MEPJ	2019-2021	Kosto administrative	Buxheti i Shtetit + BE nëpërmjet SEESAC

<i>Synimet e përgjithshme</i>	<i>Objektivat specifikë</i>	<i>Referenca aktuale</i>	<i>Aktivitetet</i>	<i>Palët përgjegjëse</i>	<i>Afati kohor</i>	<i>Buxheti i parashikuar</i>	<i>Burimi i financimit</i>
↑	↑	Ligji Nr.46/2018 është hartuar në zbatim të direktives së BE, është plotësuar Tabela e Përputhshmërisë (TOC) dhe analizës PESTEL	Zbatimi i analizës së mangësive nga grupi i punës nëpërmjet Tabelës së Përputhshmërisë (TOC) dhe analizës PESTEL përkatëse; për aktet që do dalin në zbatim të ligjit 46/2018	Ministria e Mbrojtjes AKSHE Ministria e Drejtësisë MEPJ	2019-2021	Kosto administrative	Buxheti i Shtetit + BE nëpërmjet SEESAC
